



VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT E UNIVERSITETIT JOPUBLIK “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”

Universiteti Jopublik “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” që në hapat e para të themelimit, në dokumentat bazë të funksionimit të tij, Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme, ka përcaktuar qartë vizionin, misionin dhe objektivat kryesore të veprimtarisë së tij. Ato j'u janë bërë publike dhe janë të njohura për të gjitha palët e interesuara.

Vizioni, misioni dhe objektivat kryesore të edukimit të studentëve përcaktojnë drejtimin themelor të Universitetit Jopublik “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”. Ato udhëheqin planifikimin akademik dhe zbatimin e tij në praktikë dhe njëkohësisht bëjnë të mundur përqëndrimin e të gjitha forcave të stafit akademik dhe të punonjësve ndihmës në një fokus të përbashkët, në arritjen e një shërbimi cilësor si në mësimdhënie ashtu edhe në punën kërkimore dhe shkencore.

VIZIONI

Universiteti Jopublik “S & P Qiriazi”, në të ardhmen e afërt të rritet dhe të zhvillohet, me synimin që ai të bëhet një ndër institucionet e arsimit të lartë privat më me emër në Shqipëri, në përgatitjen cilësore të specialistëve të ekonomisë dhe juristëve me drejtim biznesin.

Në përmbushje të këtij vizioni, drejtimet ose synimet kryesore të aktiviteteve edukative, mësimore dhe shkencore, të Universitetit Jopublik “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” do të jenë:

1. Të edukojë dhe të përgatisë studentë në fushën e ekonomisë dhe të jurisprudencës me qëllim që ata të bëhen “Liderë të mendimit dhe të veprimit”, specialistë të fushave përkatëse, të zhvillojë mendimin kritik dhe krijues, të zhvillojë personalitetin e tyre me qëllim që ata të kontribuojnë në zhvillimin e bizneseve dhe shoqërisë shqiptare mbi bazën e njohurive, përgjegjësive etike dhe profesionale dhe integritetit personal.
2. Të luajë një rol aktiv në zhvillimet dhe proceset ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit duke i dhënë prioritet arritjeve të standarteve europiane të arsimit të lartë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe duke garantuar rritjen e vazhdueshme të Cilësisë së Brendëshme në Universitet.
3. Të jemi institucion privat i arsimit të lartë, demokratik, transparent që gjenerojmë vlera të larta edukative, mësimore shkencore dhe shoqërore.



MISIONI

Misioni i Universitetit Jopublik “S&P Qiriazi”, është në përputhje me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Shqipëri, i cili përcaktohet në Ligjin Nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në mënyrë më specifike misioni i Universitetit Jopublik “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” është:

- Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve që u ofrohen studentëve
- Të përgatitë specialistë të lartë në fushën e ekonomisë dhe jurisprudencës - “Lider të mendimit dhe të veprimit”
- T’u ofrojë mundësi studentëve që të jenë të përgatitur për t’iu përshatur kërkesave dinamike të biznesit duke “mësuar gjatë gjithë jetës”.
- Të ndihmojë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal nëpërmjet studimeve shkencore
- Të kontribuojë në rritjen e standarteve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e brezit të ri për një shoqëri të tillë.

Duke synuar që Universiteti ynë cilësisht të dallohet nga institucionet e tjera të arsimit privat dhe publik që veprojnë në Shqipëri në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor dhe në përmbushje të vizionit dhe misionit tonë, do të rrisim eficientë e veprimtarisë në fushat e mëposhtme :

- Të ofrojmë një shërbim cilësor, të dallueshëm nga të tjerët, në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
- Të ofrojmë një staf akademik të specializuar, me eksperiencë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, me tituj dhe grada shkencore
- Të ofrojmë kushte sa më të mira fizike dhe fasilitete që lehtësojnë punën e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Të tërheqim pranë Universitetit studentë cilësorë, të cilët synojnë të arrijnë rezultate sa më të larta në fushat përkatëse të studimit
- Të krijojmë dhe stimulojmë brenda Universitetit një mjedis të tillë, në të cilin të ofrohen vlera, respekt reciprok, qëndrime etike dhe përgjegjësi personale në një shkallë sa më të lartë.
- Të inkurajojmë pjesëmarrjen aktive të të gjithë anëtarëve të Universitetit dhe palëve të interesuara në formulimin e politikave afat-shkurtra dhe afat-gjata.
- Të ofrojmë një mjedis të tillë, brenda Universitetit, në të cilin anëtarët e tij të jenë aktivë, transparent dhe analizues kritikë për të gjitha aktivitetet e zhvilluara në Universitet, të inkurajojmë diversitetin e mendimeve të cilat bëjnë të mundur bashkëpunimin midis stafit akademik dhe ndihmës, me studentët për të realizuar së bashku objektivat e caktuara dhe për të përmbushur vlerat e Universitetit.
- Të përpiqemi që të jemi institucion i arsimit të lartë privat në Shqipëri, sa më transparent në marrjen e vendimeve dhe në tërë aktivitetet që zhvillojmë në kuadër të



Universitetit për të implementuar me efikasitet të lartë programet dhe politikat tona mësimore dhe shkencore.

- Të zhvillojmë lidhje të ngushta dhe bashkëpunime reciproke me komunitetet e biznesit në rajon, të bëjmë përpjekje sa më të mëdha akademike dhe shkencore për të mbështetur dhe inkurajuar me studime shkencore zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen sot bizneset.
- Të krijojmë lidhje bashkëpunimi me Universitetet brenda dhe jashtë vendit në fusha të ndryshme me interesa reciproke, shkëmbim studentësh, vizita pune të stafit akademik, zhvillimit dhe përmirësimit të plan programeve etj.

OBJEKTIVAT

Objektivat kryesore përshkruajnë karakteristikat themelore të rezultateve të pritshme të arritjeve të studentëve në procesin mësimor, shkencor dhe edukativ. Ato synojnë të jenë në përputhje edhe me objektivat dhe standartet europiane të arsimit të lartë.

Objektivat kryesore të Universitetit “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” në ciklin e parë të studimeve janë të tilla, të cilat në tërësinë e tyre synojnë të përgatisin specialistë “liderë të mendimit dhe të veprimit” të profileve të kontabilitetit, financës, menaxhimit, marketingut, turizmit, bankës dhe institucioneve financiare dhe administrimit publik nëpërmjet:

1. Transmetimit të njohurive ekonomike dhe aftësive praktike të bazuara në metodat dhe parimet shkencore
2. Ngulitjes të qëndrimeve, parimeve të etikës, sensit të profesionalizmit dhe të aftësive të liderimit, të cilat kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit në përputhje me objektivat dhe vizionin kombëtar të zhvillimit të tij.
3. Përfitimit të aftësive për të analizuar dhe zgjidhur probleme në mënyrë kolektive dhe individuale si dhe të aftësive për të vlerësuar dhe për të marrë vendime në mënyrë krijuese duke u bazuar në evidencën dhe ekspertizën.
4. Zhvillimit të shprehive dhe aftësive individuale për të ndërmarrë kërkime shkencore dhe për të bërë analiza të thelluara në fushat përkatëse të kërkimit.
5. Zhvillimit dhe përvetësimit të njohurive dhe aftësive për të mësuar gjatë gjithë jetës, të cilat janë thelbësore për përditësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe aftësive të cilat duhet të shkojnë paralel me zhvillimet e shpejta të njohurive globale në kuadër të një shoqërie të informacionit.
6. Trainime dhe Formim profesional të vazhdueshëm, të studenteve edhe pas përfundimit të Universitetit, pranë Institutit Profesional Qyrias.
7. Npërmjet parashtrimit të problemeve dhe çështjeve të praktikës ekonomike të cilat janë tepër të rëndësishme për politikat e institucioneve ekonomike dhe financiare të vendit dhe rajonit, për periudhën e tanishme dhe për të ardhmen.